



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

V E N D I M  
K.P.P.586/2017

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Evis Shurdha	Kryetar
Leonard Gremshi	Zv/Kryetar
Hektor Balluku	Anëtar
Kleves Janku	Anëtar
Odise Moçka	Anëtar

Në mbledhjen e datës 31.07.2017 shqyrtoi ankesën me:

**Objekt:**

Shfuqizimin e vendimit të KVO-së për skualifikimin e ofertës së bashkimit të operatorëve ekonomikë “Meni & Xhengo” shpk në procedurën e prokurimit “Kërkesë për propozim”, me Nr. 16.06.201, me objekt “Mirembajtje objektesh ndertimore”, me fond limit 5.344.140 lekë pa tvsh, zhvilluar më datë 24.03.2017 nga autoriteti kontraktor, Qendra Spitalore “Xh.Kongoli” Elbasan.

**Ankimues:**

Operatori ekonomik BOE “Meni” shpk & “Xhengo” shpk  
Adresa: “Meni” shpk Rruga “Shinasi Dishnica” Pallati Unicom tek Selvia Tiranë.

**Autoriteti Kontraktor:**

Qendra Spitalore “Xh.Kongoli” Elbasan  
Adresa: Drejtoria e Spitalit, Elbasan.

**Baza Ligjore:**

Ligji Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 914 datë 29.12.2014 “Për Miratimin e

*Rregullave të Prokurimit Publik*”, Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 184, datë 17.03.2010, “Për Miratimin e Rregullores “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, i ndryshuar;

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimuesit, pretendimet e tij dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

## V Ë R E N:

### I

#### *Vlerësimi paraprak*

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës të mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky i fundit ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar;

I.2. Operatori ekonomik ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, dhe më pas ka paraqitur ankesë, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”;

I.3. Ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik;

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

### II

#### *Rrethanat e çështjes*

II.1. Në datën 13.03.2017, është publikuar nga autoriteti kontraktor, në sistemin e prokurimeve elektronike në faqen e Agjencisë së Prokurimit Publik, procedura e prokurimit “Kërkesë për propozim”, me Nr. REF-71737-03-13-2017, me objekt “Mirembajtje objektesh ndertimore”, me fond limit 5.344.140 lekë pa tvsh, zhvilluar më datë 24.03.2017 nga autoriteti kontraktor, Qendra Spitalore "Xh.Kongoli" Elbasan

II.2. Në datën 24.03.2017 autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit. Referuar procesverbalit datë 30.03.2017, në këtë procedurë prokurimi kanë marrë pjesë operatorët ekonomikë si më poshtë, të cilët pas korigjimit të ofertave nga autoriteti kontraktor, rezultojnë se kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH) përkatësisht:

1. Ndërtim –Montim “Dashi” sh.p.k. pa ofertë ekonomike
2. Bashkimi i operatorëve ekonomikë “Meni” sh.p.k.

& “Xhengo” sh.p.k.	3.093.962 lekë, skualifikuar
3. “Delia -Impex” sh.p.k.	3.130.488 lekë, skualifikuar
4. “Ina” sh.p.k.	3.582.690,5 lekë, skualifikuar
5. Bashkimi i operatorëve ekonomikë “Al Dok” sh.p.k. & “Vashtemia” sh.p.k.	3.841.526 lekë, skualifikuar
6. “Erges Mat” sh.p.k.	3.916.153,5 lekë, skualifikuar
7. “Nika” sh.p.k.	3.998.077 lekë, skualifikuar
8. “Euro-Alb” sh.p.k.	4.254.588 lekë, skualifikuar
9. “Sark” sh.p.k.	4.256.357 lekë, skualifikuar
10. “Bajrami N” sh.p.k.	4.516.854 lekë, skualifikuar
11. “Shamo Konstruksion” shpk	4.541.027 lekë, skualifikuar
12. “Climacasa” sh.p.k.	4.607.685 lekë, skualifikuar
13. “Fitore” sh.p.k. .	5.237.303 lekë, kualifikuar

II.3. Në datën 30.03.2017 operatori ekonomik ankimues “Euro-Alb” sh.p.k. është njoftuar elektronikisht për klasifikimin e ofertave si dhe skualifikimin e tij në këtë procedurë prokurimi, për arsyet si më poshtë vijon:

*Per sherbime te se njejtës natyre te realizuara keni paraqitur kontrate me subjekte privat, per kete faturat tatimore duhet te jene te shoqeruara me vertetim nga administrata tatimore per deklarimin e tyre, duke mos plotësuar Kriteret e vecanta te kualifikimit, kapaciteti teknik, pika 1 te kerkuara ne DST*

*Formulari i ofertes (Shtojca 1) nuk eshte plotësuar ne te gjithe rubrikat e tij, duke mos plotësuar Kriteret e vecanta te kualifikimit, kapaciteti teknik, pika 1.ç, te kerkuara ne DST*

II.4. Në datën 03.04.2017 operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor, duke kundërshtuar skualifikimin e tij.

[...]

*Skualifikimi i subjektit tonë nga KVO-ja është i padrejtë dhe i pambështetur në ligj. Së pari Për kontratën e ngjashme kemi paraqitur të gjitha faturat tatimore të shoqëruara me situacionet përkatëse. Nga Drejtoria e Tatimeve kemi vërtetime se subjekti ka shlyer të gjitha detyrimet tatimore për të gjithë aktivitetin duke përfshirë dhe objektin që kemi paraqitur në tender. Nga Drejtoria e Tatimeve nuk lëshohet vërtetim për fatura të vecanta pavarësisht kërkesës tonë. Theksojmë se dhe bilancet janë të konfirmuar nga Dega e Tatimeve.*

*Së dyti Shtojca 1 është plotësuar ashtu sic është përcaktuar në dokumentat e tenderit duke dhënë kuotim total. Përsa i përket pretendimit tuaj ne nuk kemi bashëngjitur me formularin e ofertës një preventive, me të gjitha cmimet e punimeve që kërkohen. Përsa më sipër kërkojmë anulimin e vendimit të KVO-së dhe kualifikimin e shoqërisë tonë.*

II.5. Në datën 06.04.2017, nëpërmjet shkresës me nr. 623 prot., autoriteti kontraktor i ka kthyer përgjigje operatorit ekonomik ankimues, duke e refuzuar ankesën.

Autoriteti kontraktor në kthimin e përgjigjes argumenton si më poshtë:

[...]

*Përsa i përket pretendimit tuaj se jeni skualifikuar në mënyrë të padrejtë theksojmë se:*

*Në bazë të verifikimeve të bëra nga ana KVO-së nuk keni plotësuar :*

*Për shërbime të së njëjtës natyrë të realizuara keni paraqitur kontratë me subjekte privat, për këtë faturat tatimore duhet të jenë të shoqëruara me vërtetim nga administrata tatimore për deklarimin e tyre, duke mos plotësuar kriteret e vecanta të kualifikimit kapaciteti teknik pika 1 të kërkuar në DST. Ju sqarojmë se përsa i përket faturave tatimore të paraqitura nga ana juaj të cilat duhet të jenë me vërtetim nga administrata tatimore, kriteri i cili është pranuar nga ana juaj dhe nuk e keni ankimuar këtë pikë në fazën e shpalljes së prokurimit.*

*Formulari i ofertës (Shtojca 1) nuk është plotësuar në të gjitha rubrikat e tij duke mos plotësuar kriteret e vecanta të kualifikimit kapaciteti teknik pika 1 ç, të kërkuara në dst. Në formularin e ofertës paraqitur nga ju nuk shtë plotësuar objekti i prokurimit.*

II.6. Në datën 12.04.2017, pala ankimuese “Euro-Alb” sh.p.k. ka dorëzuar ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik me të njëjtin objekt ankesë dorëzuar pranë autoritetit kontraktor.

II.7. Në datën 30.03.2017 bashkimi i operatorëve ekonomikë ankimues “Meni” shpk & “Xhengo” shpk është njoftuar elektronikisht për klasifikimin e ofertave si dhe skualifikimin e tij në këtë procedurë prokurimi, për arsyet si më poshtë vijon:

*Nuk keni paraqitur vërtetim realizimi për kontrata të ngjashme për operatorin Xhengo Shpk ., duke mos plotësuar Kriteret e vecanta të kualifikimit, kapaciteti teknik, pika 1 të kërkuara në DST.*

II.8. Në datën 03.04.2017 operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor, duke kundërshtuar skualifikimin e tij.

[...]

*Firma “Meni” shpk pasi është njohur me kërkesat e pjesëmarrjes në tenderin e organizuar nga AK-ja datë 24.03.2017 me objektin e mësipërm ka marrë pjesë në këtë procedurë prokurimi. Në datën 30.03.2017 nëpërmje portalit elektronik mesazhe jemi njoftuar për skualifikimin tonë.*

*Përsa më sipër sqarojmë se :*

*BOE “Meni” shpk & “Xhengo” shpk, ka hedhur në sistem formularin e vlerësimit në të cilin thuhet se shoqëria “Xhengo” shpk ka realizuar kontratën sipas kushteve të kontratës dhe KTZ në fuqi. Ky formular vlerësimi është i shoqëruar edhe me situacionin përfundimtar dhe akt kolaudimin gjë që tregon realizimin e kontratës “Mirëmbajtje objekte fizike e imjanistike” Spitali Korçë për vitin 2015. Referojmë përmbajtjen e dokumentit, si dhe nenin 53 (Shqyrtimi i ofertave)pika 3 e LPP-së. Bazuar LPP-së oferta e paraqitur në sistem nga ana jonë është në përputhje me të gjitha kërkesat e kërkuara nga AK-ja sipas DT . Ju lutem*

*Zotërinj të KVO-së rishikoni edhe njëherë dokumentacionin e hedhurnë sistem nga ana jonë.*

II.9. Në datën 06.04.2017, nëpërmjet shkresës me nr. 622 prot., autoriteti kontraktor i ka kthyer përgjigje operatorit ekonomik ankimues, duke e refuzuar ankesën.

Autoriteti kontraktor në kthimin e përgjigjes argumenton si më poshtë:

[...]

*Përsa i përket pretendimit tuaj se jeni skualifikuar në mënyrë të padrejtë theksojmë se:*

*Në bazë të verifikimeve të bëra nga ana KVO-së nuk keni plotësuar :*

*Nuk keni paraqitur vërtetim realizimi për kontratatë ngjashme për operatorin ekonomik “Xhengo” shpk duke mosplotësuar kriteret e vecanta të kualifikimit kapacitetit teknik pika 1 te DST-të.*

*Ju sqarojmë se kriteret e kërkuara për kontratat e ngjashme nuk ju janë kërkuar Akt kolaudimi; formular vlerësimi; pasi këto dokumenta kërkohej nëse objekti i prokurimit është ndërtim i ri ose rikonstruksion, por është kërkuar vërtetim realizimi të cilin nuk e keni paraqitur nga titullari i AK-së ku keni kryer punimet.*

II.10. Në datën 12.04.2017, pala ankimese bashkimi i operatorëve ekonomikë “Meni” shpk & “Xhengo” ka dorëzuar ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik me të njëjtin objekt ankese dorëzuar pranë autoritetit kontraktor.

II.11. Në datën 30.03.2017 operatori ekonomik ankimues “Erges Mat” sh.p.k. është njoftuar elektronikisht për klasifikimin e ofertave si dhe skualifikimin e tij në këtë procedurë prokurimi, për arsyet si më poshtë vijon:

*Listepagesat nuk janë të konfirmuara nga administrata tatimore duke mos plotësuar Kriteret e vecanta të kualifikimit, kapaciteti teknik, pika 3.b të kërkuara në DST.*

II.12. Në datën 03.04.2017 operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor, duke kundërshtuar skualifikimin e tij.

[...]

*Pretendimi juaj sa më lart nuk qëndron është arbitrar absolutisht i pavlefshëm dhe i kundraligjshëm për faktin se: referojmë nenin 65 pika 6 e ligjit nr. 9920 datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore”, i ndryshuar, [...]*

*Pretendimi i KVO-së të Ak-së se listepagesat e paraqitura nga operatori ekonomik “Erges Mat” shpk janë të pakonfirmuara nga administrata tatimore nuk qëndron pasi referuar dispozitës ligjore të ligjit të sipërcituar si dhe praktikës tashmë të konsoliduar të KPP-së në vendime analoge, deklarimi i listepagesave Esig 25 nga periudha tatimore Janar 2013 kryhet vetëm në mënyrë elektronike. Në si oë kemi përmbushur të gjitha detyrimet ligjore për paraqitjen e listepagesave për periudhën e këkuar nga AK-ja. Për periudhën e kërkuar nga ana juaj në si oë ankimese kemi dorëzuar listepagesat pranë administratës tatimore në përputhje me VKM-në nr. 55 datë 03.02.2010 “ Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumentave të tjerë tatimor vetëm nëpërmjet formës elektronike”. Kuadri ligjor i mësipërm parashikon se dorëzimi i dokumentave tatimorë (përfshirë dhe listepagesat) dorëzohen vetëm në formë elektronike. Është detyrë e oë të përmbushin detyrimet që rrjedhin nga kuadri ligjor në fuqi (në rastin konkret detyrimet tatimore me kërkesat e këtij të fundit. Pra gjykojmë se përmes dokumentacionit të dorëzuar në si palë ankimese kemi përmbushur kërkesën e AK-së.*

*Referojmë nenin 46 të LPP-së dhe nenin 53/3 të LPP-së.*

*Sa më sipër pretendimi ynë qëndron pasi sic sqaruam më lart dokumentacioni i paraqitur përmbush kërkesat e AK-së. Bazuar në legjislacionin në fuqi tatimor të sipërcituar, sqarojmë se listepagesat në formatin elektronik janë të konfiguruar me elementë sigurie dhe verifikimi dhe konkretisht me vulë sigurie elektronike, e cila konsiderohet si vulë konfigurimi nga vet sistemi elektronik i Drejtorisë së Tatimeve. Gjithashtu vlen të theksojmë se konfirmim tjetër për listepagesat është dhe vërtetimi i Sigurimeve Shoqërore për numrin e punonjësve e cila është në përputhje të*

*plotë me deklaratimet e bëra nga ana jonë që provon numrin e punonjësve dhe kryerjen e pagesave të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore.*

*Nëse nga ana e AK-së do të kishte dyshime apo do të ishin të paqartë në lidhje me informacionin që përmban listpagesa, kishin të drejtë që të bënin verifikimet përkatëse pranë organit tatimor ku janë dorëzuar këto listpagesa, për tu bindur për saktësinë e dokumentacionit përkatës të paraqitur në procedurën e prokurimit nga ana jonë.*

*Për rrjedhojë cmojmë se oe “Erges Mat” shpk plotëson kriterin e kërkuar nga AK-ja në DST lidhur me listpagesat e paraqitura pranë jush.[...]*

II.13. Në datën 06.04.2017, nëpërmjet shkresës me nr. 624 prot., autoriteti kontraktor i ka kthyer përgjigje operatorit ekonomik ankimues, duke e refuzuar ankesën.

Autoriteti kontraktor në kthimin e përgjigjes argumenton si më poshtë:

*[...]Përsa i përket pretendimit tuaj se jeni skualifikuar në mënyrë të padrejtë theksojmë:*

*Listepagesat nuk janë të konfirmuara nga administrata tatimore duke mos plotësuar Kriteret e vecanta të kualifikimit, kapaciteti teknik, pika 3.b të kërkuara në DST.*

*OE ofertues duhet të ketë të punësuar mesatarisht jo më pak se 35 (tridhjetë e pesë) punonjës për periudhën Dhjetor 2016-Janar 2017- Shkurt 2017. Në lidhje me këtë pikë oe duhet të paraqesë:*

*a. Vertetim nga Administrata Tatimore ose Dega e Sigurimeve Shoqërore për numrin e punonjësve të siguruar për periudhën Dhjetor 2016 - Janar 2017 – Shkurt 2017.*

*b. Listepagesat përkatëse për muajt Dhjetor 2016 - Janar 2017 – Shkurt 2017 të konfirmuara nga Administrata Tatimore.*

*Në bazë të verifikimeve të bëra nga ana e KVO-së nuk keni plotësuar këtë kriter sepse listepagesat nuk janë të konfirmuara nga administrata tatimore duke mos plotësuar kriteret e vecanta të kualifikimit kapaciteti teknik pika 3.b të kërkuara në DST. Nëse do të kishit pretendime në lidhje me këtë kriter të vendosur nga AK-ja duhet të ishit ankuar që në fazën e publikimit të dst-ve. Mosparaqitja e asnjë ankese gjatë kësaj faze tregon dakortësinë tuaj për kriteret e vendosura nga ak-ja.*

II.14. Në datën 12.04.2017, pala ankimuese “Erges Mat” sh.p.k. ka dorëzuar ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik me të njëjtin objekt ankese dorëzuar pranë autoritetit kontraktor.

II.15. Nëpërmjet shkresës me nr. 717 prot., datë 18.04.2017, të protokolluar me tonën nr. 729/2 datë 20.04.2017, është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik, informacioni dhe dokumentacioni i autoritetit kontraktor lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit dhe trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

II.16. Në datë 31.05.2017, Komisioni i Prokurimit Publik, pasi e shqyrtoi në themel ankesën e paraqitur nga operatorët ekonomikë ankimues, me vendimin K.P.P.368/2017, ka vendosur:

- 1. Të pranojë ankesën e paraqitur nga operatorit ekonomik “Erges Mat” shpk, dhe bashkimit të operatorëve ekonomikë “Meni” shpk & “Xhengo” shpk për procedurën e prokurimit “Kërkesë për propozim”, me Nr. REF-71737-03-13-2017, me objekt “Mirembajtje*

*objektesh ndertimore”, me fond limit 5.344.140 lekë pa tvsh, zhvilluar më datë 24.03.2017 nga autoriteti kontraktor, Qendra Spitalore "Xh.Kongoli" Elbasan*

2. *Të mos pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Euro -Alb” shpk për procedurën procedura e prokurimit të sipërcituar, përsa i përket kualifikimit të tyre.*
3. *Autoriteti kontraktor të anulojë vendimin e KVO-së lidhur me skualifikimin e operatorëve ekonomikë “Erges Mat” shpk, dhe bashkimit të operatorëve ekonomikë “Meni” shpk & “Xhengo” shpk duke i kualifikuar ata nga procedura e prokurimit të sipërcituar.*
4. *Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik ankimes “Erges Mat” shpk, dhe bashkimit të operatorëve ekonomikë “Meni” & “Xhengo” shpk*
5. *Autoriteti kontraktor, brenda 10 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.*
6. *Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë.*

*Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.*

II.17. Në datën 14.06.2017 autoriteti kontraktor mbas rivlerësimit (në këtë riklasifikim bashkimi i operatorëve ekonomikë “Meni” shpk & “Xhengo” shpk rezulton i kualifikuar në këtë procedurë prokurimi sipas vendimit KPP 368/2017 datë 31.05.2017. Autoriteti kontraktor në zbatim të vendimit nr.368/2017 datë 31.05.2017 të KPP-së konstatoi se nga zbatimi i formulës për ofertë anomalisht të ulët (rezultoi se oferta e paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “Meni” shpk & “Xhengo” shpk të jetë anomalisht e ulët), në datën 14.06.2017 dhe me mesazh elektronik në sistem në bazë të nenit 56 të ligjit “Për prokurimin publik” i ndryshuar i ka kërkuar bashkimit të operatorëve ekonomikë “Meni” shpk & “Xhengo” shpk të japë sqarime për analizën e çmimit si dhe për të paraqitur argumentimet e tij në lidhje me ofertën anomalisht të ulët brenda datës 16.06.2017 ora 15:00.

II.17.1. Në datën 15.06.2017 bashkimi i operatorëve ekonomikë “Meni” shpk & “Xhengo” shpk protokolluar pranë autoritetit kontraktor me shkresën nr. 1195 prot., datë 16.06.2017 paraqiti “Informacion mbi ofertën ekonomike me objekt objekt “Mirembajtje objektesh ndertimore”, sqarime të cilat pasi u shqyrtuan nga KVO-ja e autoritetit kontraktor, u vlerësuan jo të plota jo bindëse, pasi nuk është dërguar dërguar me dokumentacion justifikues (faturë tatimore të vërtetuara me librin e shitjeve të konfirmuara nga dega e tatim taksave).

II.17.2. Në datën 20.06.2017,(referuar informacionit të autoritetit kontraktor nr. 1314prot datë 11.07.2017) autoriteti kontraktor, Qendra Spitalore "Xh.Kongoli" Elbasan., ka kryer rivlerësimin e procedurës në sistemin elektronik të prokurimeve. Në këtë riklasifikim bashkimi i operatorëve ekonomikë “Meni” shpk & “Xhengo” shpk rezulton i skualifikuar në këtë procedurë prokurimi

Rezultatet e rivlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave ku rezulton si më poshtë vijon:

”Ndërtim –Montim “Dashi” sh.p.k.

pa ofertë ekonomike

Bashkimi i operatorëve ekonomikë “Meni” sh.p.k.

& "Xhengo" sh.p.k.	3.093.962 lekë,	kualifikuar
"Delia -Impex" sh.p.k.	3.130.488 lekë,	skualifikuar
"Ina" sh.p.k.	3.582.690,5 lekë,	skualifikuar
Bashkimi i operatorëve ekonomikë "Al Dok" sh.p.k.		
& "Vashtemia" sh.p.k.	3.841.526 lekë,	skualifikuar
"Erges Mat" sh.p.k.	3.916.153,5 lekë,	kualifikuar
"Nika" sh.p.k.	3.998.077 lekë,	skualifikuar
"Euro-Alb" sh.p.k.	4.254.588 lekë,	skualifikuar
"Sark" sh.p.k.	4.256.357 lekë,	skualifikuar
"Bajrami N" sh.p.k.	4.516.854 lekë,	skualifikuar
"Shamo Konstruksion" shpk	4.541.027 lekë,	skualifikuar
"Climacasa" sh.p.k.	4.607.685 lekë,	skualifikuar
"Fitore" sh.p.k. .	5.237.303 lekë,	kualifikuar

II.17.3. Në datën 20.06.2017 bashkimi i operatorëve ekonomikë "Meni" shpk & "Xhengo" shpk është njoftuar për skualifikimin e ofertës së tij në procedurën e mësipërme të prokurimit si më poshtë vijon: "[...]"

*Për argumentimin e ofertës anomalisht të ulët është kërkuar nga KVO, fatura tatimore shitje të vërtetuara me librin e shitjes të konfirmuar me degën e tatimeve, gjë e cila nuk është paraqitur nga ana juaj. Pra dokumentacioni i dërguar për justifikimin e ofertës anomalisht të ulët nuk është i plotë dhe bindës për justifikimin e kësaj oferte anomalisht të ulët, të kërkuar nga KVO.*

II.18. Në datën 21.06.2017 bashkimi i operatorëve ekonomikë "Meni" shpk & "Xhengo" shpk ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor me pretendime të reja si me poshte:

[...]

*Në klasifikimin e datës 20.06.2017 ardhur në portalin elektronik oferta jonë është skualifikuar me pretendimin se nuk kemi paraqitur fatura tatimore shitjeje të vërtetura me librin e shitjes të konfirmuara nga dega e tatim taksave.*

*Lidhur me këtë pretendim sqarojmë se :*

*Faturat tatimore të shitjeve të deklaruar në Degën e Tatimeve nuk kanë lidhje me analizën e cmimeve të ofertës së kërkuar nga KVO. Dega e tatimeve lëshon vërtetim për xhiron vjetore të realizuar nga subjekti. Ju si ak keni të drejtë të kërkonit pranë Degës së Tatimeve përkatëse të dhëna në lidhje me faturat tatimore të shitjeve të deklaruar nga subjekti për periudhën që AK-ja interesohet.*

*Në lidhje me argumentimin e ofertës anomalisht të ulët nga ana jonë është dërguar analiza e cmimit për cdo zë të ofertës mbështetur në manualin e cmimeve dhe në strukturën e kostos për cdo zë. Konkretisht material, puntori, transport, makineri, shoqëruar kjo me me fatura blerjeje me tvsh të materialeve kryesore.*



*Ju lutem zotërinj të KVO-së kërkojmë:*

*Anulimin e vendimit të marrë nga KVO-ja.*

*Kualifikimin dhe shpalljen fitues së ofertës tonë.*

*Në të kundërt do të ndjekim rrugën ligjore më tej duke ju përmbajtur afateve ligjore të përcaktuara sipas ligjit të prokurimeve.*

II.19. Në datën 22.06.2017 me anë të shkresës nr.1221/1 prot autoriteti kontraktor i ka kthyer përgjigje ankimuesit lidhur me pretendimet e parashtruara në ankesë duke vendosur refuzimin e ankesës. Konkretisht si më poshtë citon: [...] *“Autoriteti kontraktor mori në shqyrtim pretendimet e parashtruar në ankesën tuaj dhe veprimet e kryera nga KVO-ja. Pas rishikimit të dokumentacionit përjustifikim të ofertës anomalisht të ulët ju sqarojmë se nuk keni paraqitur fatura tatimore shitje (kërkuar me mesazh nga KVO me shkresën e datës 14.06.2017) në subjekte të tjera për punimet e kërkuara me cmimet e paraqitura në ofertën tuaj që autoriteti kontraktor të ketë sigurinë në kryerjen me cilësi të shërbimeve nisur nga rëndësia e institucionit shëndetësor.[.....]*

II.20. Në datën 06.07.2017, pala ankimuese bashkimi i operatorëve ekonomikë “Meni” shpk & “Xhengo” shpk ka dorëzuar ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik me argumentat si më poshtë vijon:

[...]

BOE “Meni” shpk & “Xhengo” shpk ka dërguar elektronikisht në datën 15.06.2017 dhe depozituar në formë shkresore në datën 16.06.2017 në sekretarinë e Qendrës Spiatalore “Xh. Kongoli” Elbasan argumentimin e ofertës anaomalisht të ulët kërkuar nga KVO-ja (bashkëngjitur dokumentacioni). Në klasifikimin e datës 20.06.2017 ardhur në portalin elektronik oferta jonë është skualifikuar me pretendimin se nuk kemi paraqitur fatura tatimore shitjeje të vërtetuara me librin e shitjeve të konfirmuara në degën e tatimeve. Në datën 21.06.2017 kemi dërguar pranë sekretarisë së Qendrës Spiatalore “Xh. Kongoli” Elbasan formularin e ankesës në lidhje me refuzimin e ofertës.

*Lidhur me këtë pretendim sqarojmë se:*

*Faturat tatimore të shitjeve të deklaruar në Degën e Tatimeve nuk kanë lidhje me analizën e cmimeve të ofertës së kërkuar nga KVO. Dega e tatimeve lëshon vërtetim për xhiron vjetore të realizuar nga subjekti. Ju si ak keni të drejtë të kërkonit pranë Degës së Tatimeve përkatëse të dhëna në lidhje me faturat tatimore të shitjeve të deklaruar nga subjekti për periudhën që AK-ja interesohet.*

*Në lidhje me argumentimin e ofertës anomalisht të ulët nga ana jonë është dërguar analiza e cmimit për cdo zë të ofertës mbështetur në manualin e cmimeve dhe në strukturën e kostos për cdo zë. Konkretisht material, puntori, transport, makineri, shoqëruar kjo me me fatura blerjeje me tvsh të materialeve kryesore.*

*Në datën 27.06.2017 jemi vënë në dijeni me e mail dhe në formë shkresore (zarf) datë 28.06.2017 për refuzimin e ofertës. Në shkresën dërguar me e mail nga KVO-ja nuk është i qartë edhe vet se çfarë*

kërkon të të argumentojë BOE “Meni” shpk & “Xhengo” shpk në ofertën e tij. BOE “Meni” shpk & “Xhengo” shpk e ka argumentur ofertën në bazë të nenit 56 të LPP-së pikë . Referojmë nenin[....].

Kemi dhenë shpjegim të detajuar duke përshkruar në mënyrë të hollësishme të gjithë elementët sipas pikës 1 të nenit 56 të LPP-së(dok argumentim bashkëngjitur). Qëllimi i argumentimit të ofertës është për të justifikuar cmimet, anën ekonomike, ndërsa për të garantuar realizimin me sukses të kontratës ne kemi paraqitur kontrata të ngjashme dhe të gjithë dokumentacionin e kërkuar në dst nga AK-ja. Në argumentimin e ofertës anomalisht të ulët kemi paraqitur fatura tatimore blerjeje që justifikojnë cmimin e ofertës si dhe certifikimin (TCPE)të specialistëve të kërkuar në dst. Sipas shkresës nr. 1221/1 datë 22.06.2017 kthim përgjigje thuhet: nuk keni paraqitur fatura tatimore shitje (kërkuar me mesazh nga KVO me shkresën e datës 14.06.2017) në subjekte të tjera për punimet e kërkuara me cmimet e paraqitura në ofertën tuaj që autoriteti kontraktor të ketë sigurinë në kryerjen me cilësi të shërbimeve nisur nga rëndësia e institucionit. Sipas kësaj kthim përgjigjes AK-ja është dakort me argumentimin e cmimeve të ofertës tonë, por nuk ka besueshmëri në përvojën e BOE për realizimin me cilësi të shërbimit. Lidhur me këtë sqarojmë KPP-në se BOE ka përvojë të mjaftueshme prej më shumë se 20 vjet aktivitet pozitiv në ndërtim dhe vecanërisht në rikonstrukcione të ndryshme, mirëmbajtje spitalore (2015-2017) argumentuar kjo me punën e ngjashme hedhur në sistem. Ju lutemi referojuni dhe faqes në internet ëëë. [menishpk.com](http://menishpk.com).

Referojmë nenin 1 pika 2 e LPP-së. Duke pasur parasysh afatin deri më 31.12.2017 për lëvrimin e fondit krahasuar me kohën e hapjes së ofertave mendojmë dhe jemi të sigurtë dhe mëse të besueshëm në realizimin e shërbimit të kërkuar. Duke u nisur nga fakti q oferta jonë përmbush të gjitha kriteret e kërkuara nga AK-ja në dst përfshirë dhe argumentimin e cmimit të ofertës kërkojmë nga KPP-ja:

Anulimin e vendimit të marrë nga KVO-ja

Kualifikimin dhe shpalljen fituese të ofertës tonë për këtë procedurë tenderimi.

II.21. Nëpërmjet shkresës nr. 1314 prot., datë 11.07.2017, protokolluar me tonën me nr. 1247/2 datë 13.07.2017 me objekt “Dërgim informacioni”, është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik informacioni i autoritetit kontraktor lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit.

### III

#### Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës dhe dokumentacionit bashkëngjitur kësaj ankese, si dhe informacionit të autoritetit kontraktor

#### Arsyeton

III.1 Lidhur me pretendimet e BOE “Meni” shpk & “Xhengo”shpk për kundërshtimin e skualifikimit të ofertës së tij me arsyetimin se: “[...]Për argumentimin e ofertës anomalisht të ulët është kërkuar nga KVO, fatura tatimore shitje të vërtetuara me librin e shitjes të konfirmuar me

degën e tatimeve, gjë e cila nuk është paraqitur nga ana juaj. Pra dokumentacioni i derguar për justifikimin e ofertës anomalisht të ulët nuk është i plotë dhe bindës për justifikimin e kësaj oferte anomalisht të ulët, të kërkuar nga KVO.” ,Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në nenin 56 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikon se “[...] 1. Kur autoriteti kontraktor vëren se një ose më shumë oferta për kontratat e mallrave, punëve apo shërbimeve janë anomalisht të ulëta, ai, përpara se të vazhdojë me procesin e vlerësimit të ofertave, i kërkon operatorit ekonomik përkatës të paraqesë me shkrim dhe brenda 3 ditëve pune shpjegime për elemente të veçanta të ofertës, për: a) anën ekonomike të metodës së ndërtimit, procesit të prodhimit ose të shërbimeve të ofruara; b) zgjidhjet teknike të ofruara dhe/ose ndonjë kusht favorizues të jashtëzakonshëm, që ka ofertuesi për kryerjen e punimeve, për furnizimin e mallrave apo të shërbimeve; c) origjinalitetin e punëve, mallrave apo të shërbimeve, të propozuara nga ofertuesi; ç) zbatueshmërinë e detyrimeve, që lidhen me mbrojtjen në punë dhe kushtet e punës, në vendin ku do të kryhet puna, shërbimi apo ku do të sigurohet furnizimi. 2. Autoriteti kontraktor i verifikon këto elemente duke u këshilluar me ofertuesin dhe në bazë të informacionit të paraqitur. Autoriteti kontraktor mund ta refuzojë ofertën, kur edhe pas shqyrtimit të informacionit të paraqitur nga ofertuesi, nuk bindet se ajo është e rregullt në të gjitha elementet e saj[...].”

III.1.2. Në nenin 66 pika 5 të VKM nr.914 datë 29.12.2014 për “Miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar parashikon se “Pas korrigjimit të gabimeve aritmetike, komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon nëse ofertat e vlefshme janë ose jo me çmim anomalisht të ulët sipas formulës së përcaktuar në dokumentet standarde të tenderit. Përlllogaritja e ofertës anomalisht të ulët bëhet në mënyrat e mëposhtme: Në rastin kur janë të vlefshme dy ose më pak oferta, në përputhje me nenin 56 të LPP, oferta vlerësohet anomalisht e ulët kur ajo është ulur më shumë se 25% e fondit limit të përlllogaritjes. Në rastin kur janë të vlefshme tre ose më shumë oferta, në përputhje me nenin 56 të LPP, oferta vlerësohet anomalisht e ulët nëse vlera e saj do të jetë më e vogël se 85% e mesatares së ofertave të vlefshme. Nëse një apo disa oferta vlerësohen si anomalisht të ulëta, komisioni i vlerësimit të ofertave duhet të kërkojë sqarime nga ofertuesit, përpara se të marrë vendim për kualifikimin ose jo të tyre, në përputhje me nenin 56 të LPP. Në çdo rast ofertuesi ka detyrimin të argumentojë dhe të dokumentojë me prova shkresore sqarimet për elementin/elementet e veçanta të ofertës, në përputhje me kërkesat e nenit 56 të LPP. [...]”

III.1.3. Nga interpretimi literal i nenit 56 pika 1 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se barra e provës mbi argumentin e ofertës anomalisht të ulët i përket operatorit ekonomik, oferta e të cilit është konstatuar nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave dhe në zbatim të VKM 914/2014. Gjithashtu, K.P.P. gjykon se argumentimi i ofertës anomalisht të ulët njëherazi duhet të plotësojë katër kushte kumulative për ti dhënë garanci si edhe bindje autoritetit kontraktor. Së pari, operatori ekonomik ankimues duhet të dorëzojë në mënyrë të detajuar anën ekonomike të metodës së ndërtimit, procesit të prodhimit ose të shërbimeve të ofruara, gjithashtu duhet të paraqesë para autoritetit kontraktor zgjidhjet teknike zgjidhjet teknike të ofruara si edhe në raste të veçanta dhe/ose ndonjë kusht favorizues të jashtëzakonshëm, që ka ofertuesi për kryerjen e punimeve, për furnizimin e mallrave apo të

shërbimeve. Gjithashtu është detyrë e operatorëve ekonomikë oferta e të cilëve është konstatuar anomalisht e ulët të paraqesin prova shkresore para autoritetit kontraktor në lidhje me origjinalitetin e punëve, mallrave apo të shërbimeve, të propozuara nga ofertuesi, si edhe së fundmi duhet të vërtetohet zbatueshmërinë e detyrimeve, që lidhen me mbrojtjen në punë dhe kushtet e punës, në vendin ku do të kryhet puna, shërbimi apo ku do të sigurohet furnizimi. K.P.P. gjykon se katër kushtet e mësipërme të parashikuara nga lex specialis janë kushte kumulative të cilat më anë të provave shkresore dhe argumentimeve përkatëse duhen plotësuar nga operatorët ekonomikë ankimues, oferta e të cilëve rezultojnë anomalisht e ulët. Referuar nenit 56 pika 2 të LPP-së autoriteti kontraktor i verifikon këto elemente duke u këshilluar me ofertuesin dhe në bazë të informacionit të paraqitur. Autoriteti kontraktor mund ta refuzojë ofertën, kur edhe pas shqyrtimit të informacionit të paraqitur nga ofertuesi, nuk bindet se ajo është e rregullt në të gjitha elementet e saj. K.P.P. gjykon se nga interpretimi teleologjik i normës së mësipërme (qëllimi i saj) lidhet drejtpërdrejtë me shmangijen e rrishtit që mund të sjellë një ofertë e cila rezultojnë anomalisht e ulët. K.P.P. gjykon se risku që shfaqet në rast se një ofertë rezultojnë anomalisht e ulët është në disa drejtime ku ndër të tjera si: rreziku për mos kryerjen e shërbimit/punëve në cilësinë e duhur; rreziku i tërheqjes së operatorit ekonomik nga lidhja e kontratës dhe kosto që i lindin autoritetit nga mos kryerja e shërbimit brenda afateve kohore të parashikuara; humbjet që mund të pësojë në kohë nga mos kryerja e shërbimit gjatë periudhës së ri publikimit të procedurës së tenderit në rast të mos zbatimit të kontratës nga ana e operatorit ekonomik oferta e të cilit rezultojnë anomalisht e ulët. Gjithashtu, K.P.P. thekson se referuar nenit 1 gërma “b” “Objekti dhe qëllimi” i ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikohet se “Objekt i këtij ligji është përcaktimi i rregullave që zbatohen për prokurimet e mallrave, të punëve dhe të shërbimeve nga autoritetet kontraktore të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; Mirëpërdorimi i fondeve publike përfshin jo vetëm përzgjedhjen nga autoriteti kontraktor të ofertave më të ulëta (si kriter i përzgjedhjes së ofertës fituese referuar “çmimit më të ulët”), por gjithashtu shmangien e rrishtit dhe dështimin e kontratës që mund të vijnë nga oferta të cilësuar si anomalisht të ulëta, referuar formulës së përlogaritjes të parashikuar në ligj.

III.1.4. Nga shqyrtimi i ofertës së operatorit ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se oferta në vlerën 3.093.962 lekë pa përfshirë vlerën e Tatimit Mbi Vlerën e Shtuar, në respekt të nenit 66 pika 5 të Vendimit nr.914 datë 29.12.2017 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, rezultojnë anomalisht e ulët, ndaj, autoriteti kontraktor ka vepruar drejt ku në zbatim të parashikimeve të *lex specialis*, neni 56 dhe neni 66 të VKM 914/2014 i ka kërkuar sqarime operatorit ekonomik ankimues mbi ofertën e dorëzuar në këtë procedurë prokurimi.

III.1.5. Referuar parashkrimeve me shkrim të ankimuesve dhe informacionit të dorëzuar nga autoriteti kontraktor rezultojnë se në datën 14.06.2017 autoriteti kontraktor ka kërkuar sqarime BOE “Meni” shpk & “Xhengo”shpk, mbi ofertën ekonomike e cila rezultojnë anomalisht e ulët në përputhje me nenin 56 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” të ndryshuar. Në përgjigje të kërkesës së këtij të fundit, operatori ekonomik ankimues në datën 15.06.2017 (shkesa nr. 1195 prot., datë 16.06.2017 ka parashtruar pranë autoritetit kontraktor argumenta mbi ofertën e dorëzuar në procedurën e prokurimit objekt ankimi, e konstatuar si anomalisht e ulët nga ana e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave

III.1.6. Nga shqyrtimi i informacionit dhe dokumentacionit të paraqitur nga autoriteti kontraktor rezulton se nga ana e operatorit ekonomik ankimes, me synim justifikimin/argumentimin e ofertës anomalisht të ulët është paraqitur dokumentacioni si më poshtë:

- shkresën nr. 1195prot., datë 16.06.2017, protokolluar pranë autoritetit kontraktor paraqiti “Informacion mbi ofertën ekonomike me objekt “Mirëmbajtje të objekteve ndërtimore”.
- Analiza e cmimeve
- Faturë tatimore shitjeje nr. 8120 datë 03.12.2016 (Përshkrimi i mallit ose shërbimit; Katrama)
- Faturë tatimore shitjeje nr. 313 datë 27.01.2017 (Përshkrimi i mallit ose shërbimit; Dep. 1000)
- Faturë tatimore shitjeje nr. 308 datë 02.12.2016 (Përshkrimi i mallit ose shërbimit; termostatat; rezistenc; rubinet; kosh ëc; etj)
- Faturë tatimore shitjeje nr. 393 datë 11.12.2016 (Përshkrimi i mallit ose shërbimit; Bojë)
- Faturë tatimore shitjeje nr. 1396 datë 25.03.2017 (Përshkrimi i mallit ose shërbimit; DË 1000 gri)
- Faturë shitjeje nr. 292 datë 17.12.2016 (Përshkrimi i mallit ose shërbimit:panel sanduic;llamarinë )
- Faturë shitjeje nr. 238 datë 20.01.2017 (Përshkrimi i mallit ose shërbimit:ëc+ kaset komplet;grup lavamani;grup druri; tuba freksibël; lavaman etj;
- Faturë tatimore shitjeje nr. 258 datë 20.02.2017 (Përshkrimi i mallit ose shërbimit; grup komplet; bolier;)
- Faturë tatimore shitjeje nr. 1194 datë 14.03.2017 (Përshkrimi i mallit ose shërbimit; cimento e zezë;hekur zgarë;)
- Faturë tatimore shitjeje nr. 1500 datë 03.03.2017 (Përshkrimi i mallit ose shërbimit; rërë; granil;etj)
- Faturë tatimore shitjeje nr. 2795 datë 25.03.2017 (Përshkrimi i mallit ose shërbimit; pllaka;)
- Faturë tatimore shitjeje nr. 2112 datë 28.11.2016 (Përshkrimi i mallit ose shërbimit; fishekë brave;doreza pune; mentesha; shula; akrelik; shirit ngjitës; vinovil; përzierës kolli; thika piktori; zhbllokues lavamani; celës hidraulik;brava; celës ekzagon; gërshërë lulesh;)
- Dëshmi kualifikimi (profesioni hidraulik)
- Dëshmi kualifikimi (profesioni elektrikist)

III.1.7. Nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “Meni” & “Xhengo” shpk në mbështetje të ofertës së paraqitur në procedurën e mësipërme të prokurimit, rezulton se ky i fundit, ka paraqitur dokumentacion mbështetës ose provues si: fatura tatimore, analizë cmimi, informacin mbi ofertën ekonomike; ku argumenton kushtet apo elementët e favorshëm pse kjo ofertë e dalë anomalisht e ulët duhet të pranohet dhe se nuk krijon asnjë rrezik për mosrealizimin me sukses të kontratës. Gjithashtu bazuar në arsyetimin dhe faktet e shtjelluara

më lart, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se nga ana e operatorit ekonomik – oferta e të cilit në zbatim të formulës të përcaktuar në legjislacion ka dalë anomalisht e ulët, janë paraqitur sqarime dhe dokumentacion i plotë që të argumentojnë ofertën anomalisht të ulët (në kuptim të: metodës së përzgjedhur, zgjidhjeve teknike të posaçme, kushte përjashtimisht favorizuese që gëzon ofertuesi apo origjinaliteti i punës së propozuar), duke krijuar bindjen se kjo ofertë është e rregullt në të gjithë elementët e saj me qëllim garantimin e një kontrate të suksesshme.

Sa më sipër, K.P.P. gjykon se pretendimi i autoritetit kontraktor për skualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik ankimues se *“për argumentimin e ofertës anomalisht të ulët është kërkuar nga KVO, fatura tatimore shitje të vërtetuara me librin e shitjes të konfirmuar me degën e tatimeve, gjë e cila nuk është paraqitur nga ana juaj”* nuk qëndron, pasi faturat e paraqitura nga operatori ekonomik ankimues nga pikëpamja formale dhe e përmbajtjes rezultojnë të rregullta. Akoma më tej, Komisioni i Prokurimit Publik sqaron se në bazë të nenit 62 *“Detyrimet gjatë zbatimit të kontratës”* të LPP, autoriteti kontraktor ka një rol të posaçëm, për vetë cilësimin e tij ligjor, si autoriteti me interes dhe përgjegjësi thelbësore për realizimin e suksesshëm të kontratës. KPP sjell në vëmendje se, referuar rregullave të prokurimit publik, është pikërisht autoriteti kontraktor ai që duhet të monitorojë zbatimin e kontratës, për t’u siguruar nëse cilësia e shërbimit do të jetë e njëjtë me cilësinë dhe specifikimet teknike të premtuar në ofertë dhe të përcaktuar në kontratë. Në rast të shkeljes së kushteve të kërkuara, autoriteti kontraktor zbaton penaltetet e parashikuara në kontratë, apo detyrimet, në mbështetje të nenin 62 të LPP-së, si më sipër cituar.

Sa më sipër pretendimi i palës ankimuese qëndron.

Përsa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 *“Për Prokurimin Publik”*, të ndryshuar, nenit 28 të VKM-së nr. 184, datë 17.03.2010 *“Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”*, të ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri

### Public Vendor Sector

1. Të pranojë ankesën e paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë *“Meni” shpk & “Xhengo” shpk* për procedurën e prokurimit *“Kërkesë për propozim”*, me Nr. REF-71737-03-13-2017, me objekt *“Mirembajtje objekteve ndertimore”*, me fond limit 5.344.140 lekë pa tvsh, zhvilluar më datë 24.03.2017 nga autoriteti kontraktor, Qendra Spitalore "Xh.Kongoli" Elbasan
2. Autoriteti kontraktor të anulojë vendimin e KVO-së lidhur me skualifikimin e bashkimi i operatorëve ekonomikë *“Meni” shpk & “Xhengo” shpk* duke e kualifikuar atë nga procedura e prokurimit të sipërcituar.
3. Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga bashkimi i operatorëve ekonomikë *“Meni” shpk & “Xhengo” shpk*.
4. Autoriteti kontraktor, brenda 10 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera, në përputhje me parashikimet e Vendimit nr.482 datë 05.07.2017 të Këshillit të Ministrave *“Për Pezullimin e Përkohshëm të Procedurave të Prokurimit, për Vitin 2017”*.

5. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**Nr.1247 Protokoli; Datë 06.07.2017**

### **KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**Zv/Kryetar**  
**Leonard Gremshi**

**Anëtar**  
**Hektor Balluku**

**Anëtar**  
**Kleves Janku**

**Anëtar**  
**Odise Moçka**

**Kryetar**  
**Evis Shurdha**

